

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7817  
E hënë, 24 qershor 2024  
Çmimi 0.50

Clarku: Shpresoj se do të vazhdoni t'i forconi lidhjet me ShBA-në | F. 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

## SHQIPËRIA MIRËPRET MË SHUMË TURISTË, POR ME ÇMIME MË TË LARTA



Shifrat e institucioneve në Shqipëri tregojnë rritje të numrit të turistëve në këtë vend. Të fundit, të publikuara nga Instituti i Statistikave -

Instat, janë për tremujorin e parë të vitit 2024 dhe flasin për 1 milion e 700 mijë turistë, ose 59 % më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Një çadër me dy shezlonë nuk gjenden më me afërsisht 5 euro, por mbi 7 euro, e në disa zona në jug të Shqipërisë arrijnë deri në 50 euro

**PUSHTETI INSISTON QË DRAFTI I LAJÇAKUT PËR ASOCIACIONIN TË DËRGOHET NË VENECIA** F. 5



**PRESIDENTI I SHQIPËRISË SHPALLET "QYTETAR NDERI" I DEÇANIT** F. 3



**DEPUTETJA BAJRAMI DEMANTON MINISTRIN MURATI: FATURAT E ENERGISË I SUBVENCIONOI BE-ja** F. 8

### SPORT



**KUQEZINJTË PREMTOJNË MAKSIMUMIN PËR KUALIFIKIMIN HISTORIK** F. 10

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Hungaria do ta bëjë prioritet migrimin përgjatë Presidencës së BE-së

BUDAPEST, 23 QERSHOR - Kryeministri i Hungarisë, Viktor Orban, u ka thënë medieve gjermane se ai dëshiron ta bëjë çështjen e migrimit temë kyçe kur Hungaria të jetë në krye të BE-së, në Presidencën gjashtëmujore me rotacion. Orban ka thënë për grupin

medial Funke se mirëpret pozicionin e kancelarit gjerman Olaf Scholz, i cili aktualisht është duke analizuar mënyra se si mund të kryhen procedurat e azilit prej vendeve jashtë bllokut evropian. Aktualisht presidencën e BE-së e ka Belgjika, ndërsa prej 1

korrikut në këtë pozitë do të jetë Hungaria. Orbani ka thënë se Hungaria veçse është duke zbatuar një politikë që aplikimet për azil të vlerësohen në shtetet e treta, shembull në Beograd, para se aplikuesve t'u jepet drita e gjelbër për të hyrë në shtet.



## Scholzi i shqetësuar për mundësinë e fitores së të djathtës ekstreme në Francë



BERLIN, 23 QERSHOR - Kancelari gjerman Olaf Scholz ka thënë të dielën se është i "shqetësuar" për mundësinë e fitores së të djathtës ekstreme në Francë në zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Partia e presidentit francez Emmanuel Macron është mburra në listë, sipas sondazheve, kur kanë mbetur më pak se dy javë para raundit të parë të zgjedhjeve të parakohshme, të shpallura si përgjigje ndaj epërsisë së të djathtës ekstreme ndaj partisë së tij, në zgjedhjet për Parlamentin

Evropian. "Shqetësohem për zgjedhjet në Francë", ka thënë Scholz gjatë një interviste për transmetuesin publik ARD. "Shpresoj që partitë që nuk janë [Marine] Le Pen, le të themi kështu, janë të suksesshme në zgjedhje. Mirëpo, i takon popullit francez ta marrë vendimin", ka thënë ai. Sondazhet tregojnë që aleanca në pushtet e Macronit do të dalë e treta në zgjedhjet parlamentare të 30 qershorit, ndërsa e dyta në raundin e dytë më 7 korrik - mburra Marshit Kombëtar të Le Penit dhe

aleanca së re të krahut të majtë. Kjo nënkupton se lideri i Marshit Kombëtar, Jordan Bardella, mund të bëhet kryeministri i ri i Francës, ndonëse vetëm 28-vjeçar. Ai ka thënë se do ta marrë këtë pozitë vetëm nëse partia dhe aleatët e tij do ta fitojnë shumicën absolute të ulëseve në Parlament. Partia e të djathtës ekstreme në Gjermani, Alternativa për Gjermaninë (AFD), është rritur, po ashtu, në zgjedhjet për Parlamentin Evropian, ndërsa koalicioni i Scholzit ka shënuar rënie popullore.

## Netanyahu pretendon sërish se ShBA-ja po vonon dërgesat e armëve

JERUSALEM, 23 QERSHOR - Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu i ka thënë kabinetit të tij të dielën që po vërehet "rënie dramatike" në dërgesat e armëve amerikane për përpjekjet e Izraelit në luftën në Gazë. Administrata e presidentit amerikan Joe Biden e ka mohuar këtë pretendim ditë më parë. Deklarata e Netanyahu është parë si shenjë për rritje të tensioneve mes dy vendeve aleate. Netanyahu i ka thënë kabinetit të tij se mungesat e para janë vërejtur katër muaj më parë, pa përmendur diçka konkrete, dhe se "disa pajisje kanë arritur në

mënyrë sporadike, mirëpo municionet kanë mbetur mburra". Mospajtimet mes dy vendeve kanë të bëjnë me luftën në Gazë, kryesisht lidhur me qasjen e izraelitëve në këtë konflikt dhe për sigurinë e palestinezëve atje. Presidenti Biden e ka vonuar dërgimin e disa bombave të rënda qysh prej majit, mirëpo administrata e tij i ka hedhur poshtë deklaratat e Netanyahu se bëhet fjalë edhe për dërgesa të tjera. "Pas asaj që kam dëgjuar në ditët e fundit, shpresoj dhe besoj që kjo çështje do të zgjidhet shpejt", ka thënë të dielën Netanyahu, pa dhënë më shumë hollësi. Ai i ka bërë këto deklaratat disa



orë pasi ministri izraelit i Mbrojtjes, Yoav Gallant, ka udhëtuar në Uashington për t'u

takuar me zyrtarë të lartë. Lufta në Gazë, e nxitur nga Hamasi, grupi palestinez i

shpallur terrorist prej Shteteve të Bashkuara dhe Bashkimit Evropian - më 7 tetor në jug të Izraelit, ka sfiduar marrëdhëniet Izrael - ShBA si kurrë më parë. Në atë sulm janë vrarë rreth 1 200 izraelitë dhe janë marrë peng mbi 240 të tjerë. Ministria e Shëndetësisë në Gazë deklaroi se prej nisjes së luftës janë vrarë më shumë se 37 000 palestinezë, kryesisht gra dhe fëmijë. Ndonëse ShBA-ja ka thënë se mbështet fuqishëm synimet e Izraelit për lirim të pengjeve dhe mposhtje të Hamasit, autoritetet amerikane janë të shqetësuara për numrin e viktimave palestineze dhe krizën humanitare të krijuar prej luftës.

## Anulohen fluturimet në aeroportin e Mançesterit pas problemeve me rrymë

Mançester, 23 qershor - Qindra fluturime janë shtyrë ose anuluar në Aeroportin e Mançesterit, të tretin më të madhin në Mbretërinë e Bashkuar, për shkak të problemeve me rrymë, ka njoftuar operatori i aeroportit. Sipas autoriteteve përgjegjëse, aeroporti është

prekur nga ndalja e rrymës në gjithë zonën në orët e mëngjesit. Ndonëse rryma më vonë ka ardhur, pasagjerëve në terminalin 1 dhe 2 u është thënë të mos shkojnë në aeroport, pasi të gjitha fluturimet janë anuluar deri në njoftimin e radhës. Pasagjerëve të terminalit 3 u

është thënë të shkojnë në aeroport si zakonisht, mirëpo janë paralajmëruar që mund të ketë vonesa. Ata, po ashtu, janë informuar se mund të kenë probleme në sigurim të valixheve. Pasagjerët e kanë përshkruar situatën në aeroport si "kaotike".



# Gjeneralit Clark i jepet dekorata “Dr. Ibrahim Rugova”

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Gjenerali i pensionuar amerikan Wesley Clark është nderuar të dielën në Prishtinë me dekoratën “Dr. Ibrahim Rugova” nga Lidhja Demokratike e Kosovës [LDK] për rolin e tij në çlirimin e Kosovës. Clark ka udhëhequr fushatën ajrore të NATO-s kundër caqeve ushtarake serbe më 1999. Fushata e sulmeve të NATO-s, e cila ka zgjatur 11 javë, është kryer për ta ndalur dhunën e forcave serbe kundër shqiptarëve në Kosovë. Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se emri i Clarkut është i ngulitur në themelet e krijimit të historisë së

Kosovës, dhe e ka falënderuar për mbështetjen e ofruar ndër vite. “Në momentet më të errëta, në synimet tona për liri, vendimet tuaja na kanë dhënë shpresë dhe forcë. Udhëheqësia juaj gjatë intervenimit të NATO-s ka qenë pikë kthese. Ajo nuk ka ndryshuar vetëm historinë tonë, por ka shpëtuar jetë të panumërta”, ka thënë Abdixhiku, i cili i ka kërkuar Clarkut të vazhdojë ta ndihmojë Kosovën për forcim të mëtejshëm të lidhjeve të Kosovës me Perëndimin, sidomos me NATO-n dhe Shtetet e Bashkuara. Vetë Clarku ka thënë se impresionohet secilën herë që viziton Kosovën. Ai është takuar gjatë ditës edhe me zyrtarë të tjerë të opozitës në Kosovë.

Bombardimet e NATO-s më 1999 ishin operacioni i dytë i madh luftarak i NATO-s pas sulmeve të vitit 1995 në Bosnjë-Hercegovinë. Megjithatë, ajo ka qenë hera e parë që NATO-ja - në historinë e saj të atëhershme 50-vjeçare - e ka përdorur forcën ushtarake pa miratimin e shprehur të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. NATO-ja i ka ndërprerë sulmet pas 78 ditësh - përkatësisht më 10 qershor 1999 - apo një ditë pas nënshkrimit të Marrëveshjes së Kumanovës. Me këtë marrëveshje, të negociuar ndërmjet NATO-s dhe zyrtarëve ushtarakë jugosllavë, forcat jugosllave janë tërhequr nga Kosova dhe është krijuar forca paqeruajtëse ndërkombëtare, e udhëhequr nga NATO-ja.

## Clark: Shpresoj se do të vazhdoni t'i forconi lidhjet me ShBA-në

“Shpresoj se do të vazhdoni t'i forconi lidhjet me ShBA-në dhe ta shihni atë si mike të mrekullueshme. Ne jemi krenarë me ju, për përparimin që keni bërë, për shembullin që keni treguar”, ka thënë të dielën Clark.

Gjenerali i pensionuar amerikan Wesley Clark gjatë qëndrimit në Kosovë ka vizituar edhe Gjakovën. Kryetari i Gjakovës, Ardian Gjini, shkroi në “Facebook” se me Clarkun kujtuam “ditët e angazhimit për

lirinë e vendit” dhe se folën edhe “për aktualitetin dhe të ardhmen euroatlantike të Kosovës”. “Isha jashtëzakonisht i lumtur ta pres në Gjakovë mikun e madh të Kosovës gjeneralin Wesley K. Clark. Me gjeneralin Clark evokuam kujtime nga ditët e angazhimit për lirinë e vendit e gjithashtu folëm për aktualitetin dhe të ardhmen euroatlantike të Kosovës. ShBA-të dhe Kosova pashmangshëm do jenë në një rrugë të përbashkët e të përjetshme”, ka shkruar Gjini.



# Presidenti i Shqipërisë shpallet “Qytetar Nderi” i Deçanit

DEÇAN, 23 QERSHOR - Komuna e Deçanit përmes një seance solemne ka ndarë titullin “Qytetar Nderi” për presidentin e Shqipërisë, Bajram Begaj. Në këtë ceremoni folën presidenti i Shqipërisë, Bajram Begaj, kreu i AAK-së, Ramush Haradinaj, si dhe kryetari i Deçanit, Bashkim Ramosaj. “Nga sot jam i nderuar që me propozimin e Asamblesë së Deçanit, të jem ‘Qytetar Nderi’ i kësaj krahine. Deçani është vendi ku kanë lindur burra trima, patriotë e njerëz të mençur dhe të besës, legjendat e vërteta të atdhedashurisë. Deçani ka shkrepur pushkët e para të UÇK-së. Nder për jetë trimave të

lirisë!”, ka thënë Begaj. Ndërkaq kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Begaj i nderoi me vizitë në Glllogjan. “Sot na nderoi me vizitë në familje në Glllogjan dhe në komunë në Deçan, presidenti i Shqipërisë, Shkëlqesia e tij, gjeneral Bajram Begaj me Zonjën e Parë, Armanda Begaj. Komuna e Deçanit nderoi presidentin Begaj duke i dedikuar titullin ‘Qytetar Nderi’ i Deçanit. Gjaku s’bëhet ujë, së bashku me presidentin e Shqipërisë nderuam të rënë për liri në Kompleksin Memorial ‘Dëshmorët e Kombit’ në Glllogjan”, ka shkruar Haradinaj në “Facebook”.





# Shqipëria mirëpret më shumë turistë, por me çmime më të larta

Shifrat e institucioneve në Shqipëri tregojnë rritje të numrit të turistëve në këtë vend. Të fundit, të publikuara nga Instituti i Statistikave - Instat, janë për tremujorin e parë të vitit 2024 dhe flasin për 1 milion e 700 mijë turistë, ose 59 % më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë. Një çadër me dy shezlonë nuk gjenden më me afërsisht 5 euro, por mbi 7 euro, e në disa zona në jug të Shqipërisë arrijnë deri në 50 euro

TIRANË, 23 QERSHOR - Shifrat e institucioneve në Shqipëri tregojnë rritje të numrit të turistëve në këtë vend. Të fundit, të publikuara nga Instituti i Statistikave - Instat, janë për tremujorin e parë të vitit 2024 dhe flasin për 1 milion e 700 mijë turistë, ose 59 % më shumë se në të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Pushues dhe ekspertë të turizmit e ekonomisë thonë se turizmi në vend është shtrenjtuar dhe arsyet, sipas tyre, janë nga më të ndryshmet. Mehdi Olluri, nga Lipjani i Kosovës, zgjodhi që edhe sivjet pushimet t'i bëjë në Shëngjin -

pjesa veriperëndimore e Shqipërisë.

Ai thotë se krahasuar me një vit më parë, çmimet janë më të larta.

“Ka rritje të [çmimeve të] ushqimeve në dyqane, në restorante, gjithashtu edhe banesa është më e shtrenjtë se vjet”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë.

Të dhënat e operatorëve turistikë tregojnë se të gjitha produktet turistike janë shtrenjtuar. Kështu, një çadër me dy shezlonë nuk gjenden më me afërsisht 5 euro, por mbi 7 euro, e në disa zona në jug të Shqipërisë arrijnë deri në 50

euro.

Edhe apartamentet që vjet mund të gjendeshin edhe me 25 euro, sivjet variojnë nga 30 deri në 100 euro për një natë, ndërsa dhomat në hotele nga 100 deri në 500 euro.

Çmimet, sigurisht, ndryshojnë nga zona dhe periudha - në korrik dhe në gusht janë më të shtrenjta.

Mirilda Tili, gazetare e ekonomisë në Shqipëri, thotë se turizmi sivjet është më i shtrenjtë se një vit më parë, apo në krejt pesëvjeçarit e fundit.

Arsyet, thotë ajo, lidhen me investimet në turizëm dhe tregun e punës. “Është fakt që në vitin 2024 ka struktura të shtuara akomoduese, sepse edhe lejet e ndërtimit kanë qenë për 30-40 për qind më shumë se një vit më parë. Janë shtuar hotelet që tentojnë të sjellin brende, sepse janë të përjashtuara nga taksat dhe TVSh-në e kanë 5 për qind”. “Kjo do të thotë se ka kërkesa për staf të shtuar, por se burimet janë të pakta, ka mungesë punëtorësh. Kështu që, ata pak punëtorë që gjenden, do të paguhet me

paga të larta dhe, detyrimisht, kjo është kosto që faturohet te turisti”, thotë Tili për Radion Evropa e Lirë.

Si një problem të madh ajo përmend edhe zhvlerësimin e euros. “Rënia e euros ka sjellë rritje të çdo produkti turistik. Një vit më parë euroja këmbehej me 109 lekë, ndërsa aktualisht këmbehet me 100 lekë ose më pak”, thotë gazetarja e ekonomisë.

Mbiçmimin e lekut e sheh si arsye kryesore të rritjes së çmimeve në turizëm edhe ekspertja e turizmit, Flora Xhemani Baba.

“Paketat turistike janë rritur për 10-15 %. Arsyja kryesore është luhata e madhe e euros”, sipas saj. “Ekspertët e ekonomisë kanë vlerësuar se kjo nuk ndodh për shkak të sezonit turistik dhe kërkesës së lartë, por për arsye të brendshme të qarkullimit joformal të parasë në ekonomi”, thotë Xhemani Baba. Sipas saj, një prej arsyeve që ka rritur numrin e turistëve në Shqipëri është edhe shtimi i fluturimeve ‘lowcost’, apo me çmime më të volitshme, ashtu si edhe i

fluturimeve direkte nga disa qytete të Evropës. “Tjetër arsye e rëndësishme është edhe marketingu ndërkombëtar që i është bërë Shqipërisë si nga burime zyrtare, nga vetë kryeministri dhe agjenci të turizmit, por edhe nga ata që njihen si influencues të opinionit”, thotë Xhemani Baba. Ajo shton se rritja e numrit të turistëve është një trend në të gjithë botën dhe, në këtë aspekt, turizmi në Ballkan është ndër më të kërkuarit.

“Rreth 750 milionë njerëz në botë udhëtojnë çdo vit në vendet e Mesdheut dhe Shqipëria është pjesë e kësaj pakete”, thotë Xhemani Baba.

Ajo, po ashtu, vë re se ka shtim të turistëve individualë që, siç thotë, udhëtojnë për aventura të ndryshme, e jo për turizëm plotzhi, dielli a rëre.

“... sepse, aktualisht, në plazhe është njësoj si çdo vit tjetër. Jemi në fund të qershorit dhe plazhet gjatë javës janë thujtë boshe, por qytetet turistike janë plot - Tirana, Durrësi, Berati, Kruja, Shkodra, Gjirokastra, Saranda, apo edhe qytetet e vogla si:

# Pushteti insiston që drafti i Lajçakut për Asociacionin të dërgohet në Venecia

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Zyrtarë qeveritarë insistojnë që drafti i Asociacionit të propozuar nga Bashkimi Evropian të dërgohet në Komisionin e Venecias për vlerësim.

Tri ditë para takimit Kurti - Vuçiq në Bruksel, në ekzekutiv thonë se përfaqësuesi i lartë i politikës së jashtme të BE-së, Josep Borrell apo emisari për dialogun, Miroslav Lajçak, mund ta dërgojnë draftin për opinion këshillëdhënës në Venecia, në mënyrë që krahas përmbajtjes të marrë edhe një formë zyrtare të tij.

Ndërkaq, kërkesën e qeverisë ndaj BE-së, që draft-statutin e Asociacionit të propozuar për Kosovën ta dërgojnë në Venecia, e mirëpresin edhe analistët politikë, por potencojnë nevojën që edhe Kosova t'i përmbushë

obligimet nga marrëveshjet ndërkombëtare për Asociacionin.

Zëvendësministri i Drejtësisë, Vigan Qorrolli, thotë për KP se BE-ja dhe Lajçaku duhet ta legalizojnë draft-statutin për themelimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Kosovë.

Ai shton se në formën aktuale si një non-paper pa një nënshkrim, logo, si dhe e ndarë nga marrëveshja e Brukselit dhe Ohrit, qeveria e ka të pamundur të dërgojë në Gjykatën Kushtetuese. "Meqenëse Bashkimi Evropian po insiston dhe zyrtarisht ata nuk po e deponojnë draft-statutin në institucionet e Kosovës. Ai ka një përmbajtje, por nuk ka një formë në mënyrë që ai të (shqyrtohet) nga Gjykata Kushtetuese

nesër. Institucionet e Bashkimit Evropian, në këtë rast z. Lajçak apo Borrell dhe mekanizmat përcjellëse të tyre, ta dërgojnë në Komisionin e Venecias. Venecia është një trup e cila merret me çështjet e sundimit të së drejtës dhe demokracive që kanë lindur me vonë. Institucionet e BE-së mund ta dërgojnë dhe t'i kërkojnë një opinion këshillëdhënës, i cili nuk është obligues. Venecia pastaj dhe Gjykata Kushtetuese të bëhen dy vendime figurativisht. Z. Lajçak duhet ta legalizojë arsyen e vet dhe ta legalizojë, përndryshe s'ka kuptim", thotë ai.

Analisti politik Dorajet Imeri thotë se për të dalë nga ngërçi aktual në dialog dhe për të tentuar t'i jepet zgjidhje temës së Asociacionit, do të ishte

mirë që BE-ja ta dërgojë në Venecia draftin e Asociacionit të propozuar për institucionet kosovare. "Dërgimi i draftit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe në Komisionin e Venecias nëse do të ishte e pranuar praktikisht sipas normave të aplikueshme. Do të ishte mirë për t'i dhënë një dimension më kritik përmbajtjes së këtij dokumenti. Natyrisht për t'i vijuar më tej në plotësimin e obligimeve ndërkombëtare që ka Kosova. Në radhë të parë në dërgimin e draftit në Gjykatën Kushtetuese që do ta nënkuptonte përmbylljen e obligimeve që ka Kosova në këtë fazë", thekson ai.

Megjithatë, njohësi i integriteteve evropiane, Dritëro Arifi, deklaroi se BE-ja nuk e ka obligim ta dërgojë draftin e

Asociacionit në Venecia. Sipas tij, themelimi i Asociacionit është një obligim i Kosovës, andaj kërkesat e tilla Arifi i konsideron më shumë si elektorale sesa racionaliste. "Bashkimi Evropian nuk e ka obligim të dërgojë asgjë askund. Në fund të ditës ai është një obligim yni ndërkombëtar që ne duhet ta zbatojmë", ka deklaruar ai.

Qeveria e Kosovës refuzon ta dërgojë në kushtetuese draftin e BE-së për Asociacionin duke kërkuar nga BE-ja që atë draft ta dërgojë në Komisionin e Venecias.

Kryeministri Albin Kurti do të takohet me presidentin e Serbisë, Aleksandar Vuçiq, më 26 qershor në Bruksel, ku temë kryesore do të jetë zbatimi i marrëveshjes së Brukselit dhe aneksit të Ohrit.



Gramshi, Belshi, Puka, Dibra, Përmeti, që ofrojnë turizëm të aventurës dhe trashëgimisë kulturore", thotë Xhemani Baba.

## Më shumë turistë, por shpenzojnë më pak

Ajo dhe ekspertë të tjerë ngrenë shqetësimin, po ashtu, për mosdeklarimin e të ardhurave nga turizmi. Sipas saj, autoritetet e vendit nuk duhet të përqendrohen te numrat, por te të ardhurat.

"Nëse kemi të ardhura prej 4.2 milionë eurosh në vitin 2023 me

10 milionë turistë... i bie që një turist vjen për 4-5 ditë dhe shpenzon rreth 350 euro... Ose diçka nuk shkon me shifrat e turistëve, ose evazioni është shumë i lartë", thotë ajo.

Sipas Fjerolt Ozunit, ekspert dhe operator turistik në Shqipëri, sektori i turizmit nuk është ende i qëndrueshëm. "Ne duhet të mësojmë se si ta bëjmë turistin e huaj të shpenzojë këtu te ne. Duhet të mësojmë t'i shesim paketat në mënyrë të tillë që ata t'i harxhojnë paratë. Ka nga ato grupe që vijnë dhe thonë që nuk kemi se si t'i

shpenzojmë... kishim parashikuar të shpenzonim më shumë", thotë Ozuni për Radion Evropa e Lirë.

Të dhënat e Bankës së Shqipërisë tregojnë se të ardhurat nga turizmi në periudhën janar-mars 2024 arritën në 778 milionë euro nga 624 milionë sa ishin në të njëjtën periudhë të një viti më parë por, sipas tyre, një turist shpenzoi më pak se një vit më parë. Sivjet një turist i huaj shpenzoi mesatarisht 513 euro, ndërsa në janar-mars të 2023-s kjo shifër ishte 582 euro.

Më 18 qershor Administrata Tatimore e Shqipërisë u bëri thirrje bizneseve që operojnë në fushën e turizmit, ta deklarojnë numrin real të punonjësve si dhe pagat reale të tyre. Në letrën sensibilizuese u tha se do të nisin kontrole fizike dhe se do të ketë edhe masa ndëshkuese. Vitin e kaluar mediet ndërkombëtare e renditën Shqipërinë si një ndër destinacionet më interesante të atij sezoni veror, qoftë për plazhet, zonat malore, ushqimet apo edhe çmimet e volitshme. "Turizmi masiv i ka sjellë vendit

shumë të ardhura, por duhet t'i synojmë majat e industrisë turistike botërore", tha atëkohë kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama.

Për ta përballuar fluksin e turistëve gjatë këtij sezoni, drejtori i përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Muhamet Rrumbullaku, firmosi një urdhër për anulimin e lejeve të pushimit për punonjësit që kanë detyrë sigurinë dhe mbarëvajtjen e sezonit turistik. Sipas këtij urdhri, lejet anulohen nga data 20 qershor deri më 15 shtator.

# Veprimtari Sali Bislimi afron Lezhën me Zvicrën

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Një delegacion i Lezhës në krye me kryetarin e Bashkisë, Pjerin Ndreu, po qëndrojnë për vizitë në Zvicër. Veprimtari Sali Bislimi, i cili jeton dhe vepron në Zvicër, është duke e shoqëruar delegacionin e Lezhës në këtë vizitë. "Ditën e vazhduam edhe në Parlamentin e Zvicrës, ku u pritëm nga parlamentari, miku ynë Reto Nause, kënaqësi ishte edhe takimi me ambasadorin e Shqipërisë në Zvicër z. Mustafa Nano, kisha

nderin t'i mirëpriti edhe në zyrën time ligjore ku biseduam shumë tema të interesit kombëtar, pa dyshim përfituam dhe shijuar edhe bukurit e natyrës në kantonin Jura, parkun natyral në lumin 'Doux' që ndan Zvicrën me Francën. Shumë faleminderit miku im Reto! Faleminderit mik Pjerin! Kombi ynë ka vetëm një flamur kur i duhet bashkimi! Rroftë Lezha historike Kastriotike!", ka shkruar Bislimi në "Facebook".



## QKUK-ja me laboratorë të ndryshkur, por saktësia e analizave s'vihet në dyshim

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Në ambiente me lagështi e ndryshk, laborantët e Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) kryejnë mijëra analiza në ditë - të gjakut, të pështymës, të urinës e të tjera.

Inventari i dëmtuar dhe mungesa e ventilimit ua vështirësojnë punën edhe më shumë, edhe pse aparaturat janë kryesisht të reja. "Nuk kemi as ku t'i vendosim mostrat për analiza. Jemi shumë ngushtë", thotë një infermiere e laboratorit të Internes në Klinikën e Biokimisë, që nuk dëshiron të identifikohet.

Biokimia ka në menaxhim 12 laboratorë që janë të shpërndarë në klinika të ndryshme të QKUK-së.

REL-i vizitoi disa nga ta - në Klinikën e Pediatrisë, të Infektives, të Dermatologjisë e të tjera.

Në Pulmologji pa se laboratorit ishte improvizuar në një korridor, ndërsa frigoriferi ku ruheshin mostrat ishte i vogël dhe i ndryshkur.

Në Pediatri, përveç aparaturës për analiza që është e re, ambienti i punës dhe inventari duken tejet të vjetër. "Shpesh, në hapësirat e ngushta ku punojmë, jemi tre ose më shumë teknikë e laborantë", thotë një punonjëse e laboratorit aty.

Në laboratorin e Emergjencës mungesa e hapësirave bën bashkë epruvetat, dokumentet e papuçet e stafit.



Ndërsa në Infektivë dollapi ku ruhen dokumentet duket se mezi qëndron.

Për shkak të kushteve të këqija, Klinika e Kardiologjisë ka më shumë se nëntë muaj që e ka zhvendosur laboratorin e saj në Klinikën e Biokimisë.

Në Kardiologji merren vetëm mostrat, ndërsa në Biokimi kryhen analizat.

Një infermiere thotë se stafit i

duhet të endet dhjetëra herë në ditë në mes të dy klinikave.

Drejtori i Klinikës së Biokimisë, Shemi Veseli, thotë se të gjithë laborantët "janë lënë nën mëshirën e kohës". "Në shumicën e tyre nuk ka ventilim, nuk ka ndriçim e nuk duhet të ketë as lagështi... Unë e kuptoj se nuk mund të ketë investime të shpejta e të shtrenjta, por inventarë duhet të kemi, tavolina

e karrige", thotë Veseli për Radion Evropa e Lirë.

Pavarësisht prej kushteve të tilla prej vitesh, Veseli siguron se rezultatet e analizave janë gjithmonë të sakta. "Ato nuk mund t'i kontestojë askush, faktet flasin. Vitin e kaluar kemi pasur mbi dy milionë analiza", thotë Veseli.

Këtij pohimi i bëjnë jehonë edhe në Shërbimin Spitalor Klinik dhe

Universitar të Kosovës (ShSKUK) i cili ka në përgjegjësi QKUK-në dhe spitalet rajonale.

Sipas drejtorit Elvir Azizi, në të gjitha këto institucione "analizat janë të sakta dhe të besueshme". Sa iu përket kushteve të punës, Azizi thotë se është duke u punuar për përmirësimin e tyre. "Së pari jemi duke punuar në centralizimin e laboratorëve, në mënyrë që infermierët të mos lëvizin me mostra nga klinika në klinikë. Pra, do të kemi sistem të ri për bartjen e mostrave", thotë ai.

Azizi tregon, po ashtu, se është formuar një komision që është duke i identifikuar hapësirat e reja për laboratorë. "Në secilën klinikë do të ketë ndarje për ta", thotë drejtori i ShSKUK-së.

REL-i pyeti Inspektoratin Shëndetësor të Kosovës, i cili funksionin në Ministrinë e Shëndetësisë, se si e vlerëson gjendjen në laboratorët e QKUK-së, por ai nuk ktheu përgjigje konkrete. "Varësisht gjetjeve, jepen edhe rekomandimet - gjithmonë konform kompetencave dhe dispozitave ligjore në fuqi", thuhet në përgjigje.

Kushtet e këqija në laboratorët e QKUK-së nuk janë të izoluar.

REL-i raportoi në muajin mars për situatë të ngjashme në gjithë Klinikën e Psikiatrisë.

Problemet me aparaturat dhe pritjet e gjata për shërbime janë sfida që e përcjellin punën e QKUK-së.

## Kurti: Brenda tri viteve presim të kemi 7 milionë dokumente të digjitalizuara

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Kryeministri Albin Kurti ka folur edhe një herë për digjitalizimin e dokumenteve në Kosovë, duke ritheksuar se brenda tri viteve në këtë proces do të përfshihen rreth 7 milionë dokumente.

"Digjitalizimi masiv i lëndës arkivore është duke u zhvilluar në Kosovë për herë të parë. Me skanerët më të avancuar, me rezolucion të lartë tashmë të vendosur, në 3 vjet, ne presim të kemi më shumë se 7 milionë dokumente të digjitalizuara",

ka shkruar Kurti në platformën "X", duke shtuar se në kohën tonë arkivi digjital është një mjet thelbësor për ta ruajtur kujtesën tonë institucionale dhe kolektive si dhe për t'i bërë ato më të qasshme për publikun.



## Deputetja Bajrami demanton ministrin Murati: Faturat e energjisë i subvencionoi BE-ja

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Deputetja e LDK-së, Hykmete Bajrami, i ka reaguar ministrit të Financave, Hekuran Murati, i cili tha se për 6 muaj me radhë, qeveria i ka mbështetur 61 mijë familje të cënueshme duke ua subvencionuar faturat e energjisë elektrike. Bajrami në "Facebook" deklaroi të Muratit e ka cilësuar propagandë të ministrit që rritjen e varfërisë mundohet ta shesë si sukses.

Ajo tha se 61 mijë familjet e subvencionuara për faturat e energjisë elektrike në gjashtë muajt e fundit janë bërë me fonde të BE-së, për familjet pa të ardhura ose me të ardhura të ulëta. "Pra Bashkimi Evropian është institucioni që duhet të falënderohet për këtë ndihmë e Qeveria Kurti me ministër Muratin duhet të mbahet përgjegjëse që përkundër faktit që erdhën në pushtet duke premtuar lirim të çmimit të energjisë

elektrike e rritën atë deri në papërballueshmëri për 61 mijë familje në Kosovë", ka shkruar Bajrami. Më tutje, ajo e kritikoi qeverinë duke thënë se falë politikave dhe, sipas saj, mospunës së qeverisë Kurti, sot 61 mijë familje apo rreth 250 mijë banorë jetojnë në varfëri ekstreme "dhe ministri i Financave mundohet që këtë ta shesë si lavd". "Propaganda nuk kalon!", ka shkruar Bajrami.



## Guvernatori Ismaili takon Szunyogun, flasin për përgatitjet për anëtarësim në Zonën Unike të Pagesave në Euro

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendësguvernatori Dardan Fusha, ka takuar ambasadorin e Zyrës së BE-së në Kosovë, Tomas Szunyog. BQK-ja ka njoftuar se Szunyog e ka informuar lidhur me zhvillimet kryesore në sistemin financiar, avancimin e kornizës ligjore dhe rregullative, si dhe mbi qëndrueshmërinë dhe integritetin e sistemit financiar të vendit. Me theks të veçantë, guvernatori Ismaili e informoi ambasadorin Szunyog lidhur me veprimet e

ndërmarra nga BQK-ja për anëtarësim në Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA), duke përfshirë hartimin e kuadrit ligjor të nevojshëm, që financohet nga Bashkimi Evropian dhe zbatohet nga Banka Botërore si pjesë e një projekti rajonal. "Guvernatori Ismaili potencoi se hyrja e Republikës së Kosovës në sistemet e BE-së do ta lehtësonte tregtinë dhe do të kontribuonte në krijimin e një sistemi efikas, të sigurt dhe më të integruar të pagesave, që do t'u shërbente nevojave vendit tonë për rritje ekonomike", theksohet në komunikatë. Gjatë këtij takimi ambasadori

Szunyog tha se BE-ja mbetet e përkushtuar ta mbështesë rrugën e Kosovës dhe BQK-në në plotësimin e kushteve ligjore dhe teknike për anëtarësimin në SEPA, si elemente kyç edhe për Planin e Rritjes, si dhe integrimin e vendit tonë në familjen evropiane dhe përfitimet prej saj. Në fund, guvernatori Ismaili shprehu mirënjohjen e BQK-së për mbështetjen e treguar nga ana e BE-së për sistemin financiar dhe ekonominë e Kosovës, përmes programeve të shumta të mbështetjes financiare nga institucionet e Bashkimit Evropian dhe Bankës Qendrore Evropiane.



## Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 28,3 milionë euro



PRISHTINË, 23 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar të dhënat lidhur me rrjedhat e eksportit dhe importit për muajin maj 2024. Të dhënat nga Tregtia e Jashtme të Mallrave në Kosovë tregojnë për një deficit tregtar prej -2,9 % në muajin maj 2024, në raport me periudhën e njëjtë të vitit 2023, gjegjësisht në vlerë prej 430,6 milionë eurosh krahasuar me deficitin prej 443,4 milionë eurosh në vitin 2023. Eksporti mbulon importin me 16,6 %. Eksporti i mallrave në muajin maj 2024 kishte vlerën 85,7 milionë euro, ndërsa importi 516,3 milionë euro, që është një rritje prej 14,6 % për eksport, si dhe një rënie prej (-0,3 %) për

import, duke krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2023. Sipas të dhënave të grupeve kryesore të eksportit: 24,3 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre; 13,5 % e përbëjnë plastika, goma dhe artikujt prej tyre; 11 % e përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10,5 % e përbëjnë artikujt e ndryshëm të prodhuar; 8,9 % e përbëjnë produktet minerale etj. Ndërsa sipas të dhënave të grupeve kryesore për import: 13,5 % e përbëjnë produktet minerale; 12,1 % e përbëjnë makineritë, pajisjet mekanike dhe elektrike; 12 % e përbëjnë mjetet e transportit; 11,7 % e

përbëjnë ushqimet e përgatitura, pijet dhe duhani; 10,2 % e përbëjnë metalet bazë dhe artikujt prej tyre etj. Eksportet e Kosovës në vendet e BE-së arritën në 28,3 milionë euro, ose rreth 33,3 % e eksporteve të përgjithshme, me një rritje prej 29,5 %. Partnerët kryesorë për eksportin e mallrave në BE ishin: Gjermania (11 %), Italia (4,6 %), Holanda (2,3 %) etj. Importet e Kosovës nga vendet e BE-së ishin rreth 234,6 milionë euro, ose 45,4 % e importeve të përgjithshme, me një rritje prej 9 %. Importet me pjesëmarrje me të lartë ishin nga: Gjermania (14 %), Italia (5,8 %), Greqia (6 %) etj.

## Më shumë energji elektrike e prodhuar në Termocentrale në muajin prill 2024

PRISHTINË, 23 QERSHOR - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar "Statistikat e Energjisë" për muajin prill 2024 me të dhëna për prodhimin dhe konsumin e thëngjillit, prodhimin dhe konsumin e energjisë, importin dhe eksportin e

energjisë, si dhe importin dhe eksportin e energjentëve të tjerë. Gjatë muajit prill të vitit 2024 Energjia Elektrike bruto në Dispozicion ishte 523.06 GWh, kurse konsumi i energjisë elektrike ishte 377.14 GWh apo -14.76 % më i vogël me muajin

e njëjtë të vitit paraprak. Pjesëmarrja e energjisë elektrike alternative në kuadër të konsumit të përgjithshëm ishte 17.79 %. Prodhimi i thëngjillit ishte rreth 688.75 mijë tonë ose 16.74 % më shumë se në muajin e njëjtë të vitit paraprak.



# Henry Moore, Lufta e Dytë Botërore dhe politika e ditëve të sotme



Nga: **Jonathan JONES** / *The Guardian* (titulli: **No perky cockneys? How Henry Moore's sheltering souls puncture our blitz bravado**)

Kur bombardimet e Londrës nisën në shtator 1940, londinezët e kërkuan sigurinë në stacionet dhe tunelet e thella nëntokësore – ndërsa Henry Moore, artisti më i famshëm modern britanik i asaj kohe, zbriti poshtë për t'i shikuar ato. Vizatimet e tij të frikshme të njerëzve të shtrirë ngjitas në rreshta ose të ulur të drobitur në tunelet e hirta, janë befasuese dhe çorientuese meqë nuk e kanë asnjë ngjashmëri me mitet tona për Luftën e Dytë Botërore.

Ku janë punëtorët e guximshëm londinezë që sfidojnë bombat naziste? Këta njerëz që gërmojnë në tokë për të mbijetuar, duken më shumë të dëshpëruar sesa të pathyeshëm. Këto vepra as nuk duken si britanike: në vend që të ndalet në detajet e çuditshme të posterëve të metros ose mureve që do t'i lokalizonte ato, Moore abstragon shpirtat e strehuar. Vizatimet duket se mishërojnë vuajtjet në të gjithë Evropën e viteve 1940.

Imazhet – me laps, shkumës dhe ngjyra uji – po shfaqen në Institutin Courtauld në Londër dhe vijnë në kohën e duhur, sepse kanë

shumëçka për të na treguar për patriotizmin britanik, për Luftën e Dytë Botërore, për fitoren e laburistëve më 1945.

Sigurisht, britanikët mbijetuan dhe, siç ua ka kujtuar të gjithëve 80-vjetori i Ditës-D, ata iu gëzuan fitores së famshme. Por, menjëherë më pas nuk e votuan liderin e kohës së luftës, Winston Churchill. Zgjedhjet e vitit 1945 i lanë konservatorët e Churchillit me vetëm 197 vende në Kuvend, në krahasim me 393 ulëset e laburistëve – shumica më e madhe e votave për laburistët deri atëherë. Deri tash. E djathta pëlqen të ndalet te guximi i Britanisë gjatë kohës së luftës, që trajtohet sot si ideal i lavdisë së humbur kombëtare. “Ky nuk është më vendi për të cilin brezi i Ditës-D luftoi për ta shpëtuar”, ishte një koment i fundit në *The Daily Telegraph*, duke harruar se pikërisht kjo e frymëzoi këtë zhvendosje të madhe tek e majta. Përshkrimet e Mooreit tregojnë pse. Ata që nuk mund të flenë dhe ata strehues të ndrydhur nuk shfaqin asnjë heroizëm, asnjë madhështi – dhe, asnjë pabarazi. Në mënyrë spontane i organizojnë shtretërit dhe me mirësjellje reciproke. Nga frika vjen ndjesia e re e komunitetit. Zhduken dallimet klasore që ishin realitet kaq dërrmues i jetës britanike. Kur rezultati i luftës ishte larg, në veprat

e veta Moore nuk insiston të tregojë se këta njerëz do të fitojnë, apo se do të mbijetojnë. Por, sugjeron se përvoja i ka ndryshuar.

Ne, gjithashtu kemi kaluar nëpër një tunel të gjerë e misterioz të traumave shoqërore. Ka dallim të madh në krahasimet mes bllokimit të pandemisë me përvojën e bombardimeve – megjithëse jo aq shumë po të ishe në linjën e parë mjekësore apo po të humbje anëtarët e familjes. Vizatimet e Mooreit përshkruajnë njerëzit që janë detyruar të jenë së bashku, në vend që të mbyllën veçmas. Megjithatë, këto imazhe të durimit dhe qëndrueshmërisë pasive bëjnë me dije për ngjashmërinë psikologjike midis dy krizave. Pra, është e mundur që pandemia, po si lufta, ta kishte shtyrë Britaninë majtas edhe pa gënjeshtat, gostitë ilegale dhe ekonominë katastrofike të cilën konservatorët ia shtuan kësaj traume. Churchilli ishte udhëheqës jashtëzakonisht elokuent, i cili në vitin 1945 mund të qëndronte me një fitore unike ushtarake – por, u la mënjanë. Konservatorët udhëhoqën tmerrësisht keq në pandemi dhe fati i tyre, në përputhje me rrethanat, mund të jetë më i keq. Megjithatë, ka një arsye tjetër, më të thjeshtë se pse vizatimet e Mooreit janë kaq të rëndësishme. Këto janë padyshim zgjedhjet e

para që nga viti 1945, në të cilat vetë Lufta e Dytë Botërore ka luajtur rol të rëndësishëm. Janë dokrra shumëçka nga gjërat që janë menduar për gabimin e Ditës-D të Rishi Sunakut, përfshirë zhurmën e shkaktuar nga Nigel Farage. Megjithatë, shkon në thelbin e humbjes së kontaktit të konservatorëve me karakterin e vërtetë të patriotizmit britanik. Keqkuptimi i luftës dhe asaj që ajo thotë për Britaninë është në qendër të “arritjes” kurorëzuese të konservatorëve: Brexit-i.

Sunak ka marrë pjesë në përkujtimin kombëtar britanik, por e humbi atë ndërkombëtar. A mund të ketë qenë përlllogaritje e këshilltarëve të tij se votuesit britanikë kujdesen vetëm për heroizmin britanik? Sido që të jetë, u zbulua gabimi i nacionalizmit të djathtë. Sepse, nëse Britania qëndronte e vetme në vitin 1940, kur Moore nisi Vizatimet nga Strehimoret, ajo nuk rezistonte vetëm për veten. Këmbëngulja e Mooreit për universalitetin e strehuesve kap bujarinë e luftës së Britanisë. Lufta për të cilën jemi më patriotë ishte akt altruist në emër të të gjithë Evropës, jo të ndonjë Anglie të vogël.

Budallai i Reformës në Mbretërinë e Bashkuar, i cili tha se ne duhej të ishim neutralë dhe ta linim Hitlerin rehat, tradhtonte një të vërtetë për Luftën e Dytë

Botërore (më vonë kërkoi falje dhe i tërhoqi deklaratat). Hitleri nuk e kishte asnjë dëshirë të madhe për ta pushtuar Britaninë dhe do të kishte pranuar vazhdimësinë e Perandorisë Britanike teksa krijonte Rendin e tij të Ri në të gjithë Evropën Lindore. Në vend të kësaj, Britania shkoi në luftë për Poloninë (dhe pilotët e saj iu kundërpërgjigjën duke luajtur rol të madh në mbrojtjen e Britanisë).

Por, të gjithë ne – shumica prej nesh – e dimë se pse pikëpamja e tillë revizioniste (dhe instinkti jo i ndryshëm për të braktisur Ukrainën) është i gabuar dhe monstruoz. Është dashur të luftojmë. Do të kishte qenë tradhti e turpshme ndaj diçkaje që britanikët në ato ditë e quanin “mirësi”. Në një farë mënyre, është normale që këto zgjedhje përndiqen nga fantazmat e Luftës së Dytë Botërore – të paraqitur në mënyrë të përkryer në spektakrat e Mooreit. Versionet e ndryshme të patriotizmit britanik tani po e luftojnë atë. Dhe, Moore na tregon se cili do të fitojë.

Kur i shikoni këto vizatime, shihni njerëzit që ia bëjnë vendin njëri-tjetrit për të fjetur në tunele. Pra, çfarë nëse Britania mbetet ishull i vetmuar në një botë ku gjithnjë e më shumë populistët përfitojnë nga urrejtja? Kemi qenë atje më parë. /Përkthimi: *Telegrafi.com*



# Aktori duhet të jetë si Kazanova – çdo rol i ri të jetë dashuria e parë dhe e fundit!

Si aktor, rolet e tij të tronditnin. Por, vetëm pas bisedës me të kuptova thellësinë dhe mirësjelljen e vërtetë të Donald Sutherlandit (17 korrik 1935 – 20 qershor 2024).



Nga: **Robbie COLLIN**, kritik filmi / *The Daily Telegraph* (titulli: **Donald Sutherland was a dream to interview – then he emailed me out of the blue**)

Në vitin 2015, pak para premierës të filmit të katërt të Lojërave të urisë [Hunger Games], u ula në një hotel në Londër, bashkë me Donald Sutherlandin i cili e luajti rolin e Presidentit tiranik Snou në serinë e fantazisë me aktorë të rinj. Në atë kohë, Sutherlandi më në fund u pajtua me djalën e vet Kiefer, i njohur si Xhek Baueri në serinë televizive 24: që të dy kishin pak kontakte gjatë jetës së hershme të Kieferit, por sapo kishin xhiruar një film së bashku – një western të quajtur Braktisja [Forsaken], për një baba dhe një bir të distancuar nga njëri-tjetri, në përpjekjen për të shëruar plagët e vjetra.

Si person me plot mendime dhe i shoqërueshëm, ishte ëndërr të intervistojë Sutherlandin. Por, për shkak se çdo përgjigje ishte histori

më vete – që pasurohej me atë baritonin e natyrshëm kanadez – biseda rridhte si uji, dhe pikërisht teksa po hynim në temën e raporteve të tij me të birin, dikush nga marrëdhëniet me publikun doli nga gardëroba dhe tha se koha jonë mbaroi.

Disa ditë më vonë, një email ishte në inboksen e emailit tim nga dikush që veten e quante “Frank Racette”. Ishte Sutherlandi. (E veja e tij është aktorja kanadeze Francine Racette.) Fundi i tillë i bisedës tonë, atë ashiqare e kishte mërëzitur, kështu që i kishte shkruar 700 fjalë mbi temën e Braktisjes dhe të atësisë – duke kujtuar kohën e tij me [regjisorin Federico] Fellinin, duke cituar [poetin Philip] Larkinin dhe duke kujtuar thashethemet klasike të Holivudit. Në fund, e kishte bashkangjitur një fotografi të tij dhe të Kieferit – së bashku, në sheshxhirim.

Në atë kohë mbeta i shtangur. Nëntë vjet më vonë, duke lexuar përsëri fjalët e tij, e gjej veten të prekur aq sa nuk mund të

shprehem. Sutherlandi shkroi thujse fliste dhe aktronte – që do të thotë kishte magnetizëm të kontrolluar, por sensual, dhe gjithashtu një ndjenjë intuitive për natyrën e çuditshme të bashkimit të pikave të kundërta të përvojës njerëzore. Nuk mund të largohesh nga performanca e mirë e Sutherlandit (në këtë rast nga emaili) pa ndier se vetë realitetit i është dhënë një ushtrimë dhe se pjesët e tij bien në një rend të ri zbulues – ndoshta ngushëllues, por me raste jo.

Epoka e tij e moshës së shtyrë dha rezultate të jashtëzakonshme: vlen të përmendet injeksioni jetik i seriozitetit dhe zymtësisë të cilin ia dha filmave të Lojërave të urisë, si dhe ngrohtësia e thellë atërore të cilën e solli në rolin e z. Benet te Krenaria dhe paragjykimi [Pride and Prejudice] të regjisorit Joe Wright. Por, ishte faza e tij e hershme – filmat Don't Look Now, Klute, Invasion of the Body Snatchers, The Day of the Locust, Ordinary People, Fellini's Casanova – që e bëri Sutherlandin

të jetë prani të pashlyeshme për brezat e tërë të adhuruesve të kinemasë.

Nuk mund të numëroj se sa herë e kam parë filmin Mos u kthe [Don't Look Now], por nuk jam ende plotësisht i përgatitur për të shkruar për ashpërsinë magjepsëse të performancës së tij si Xhon Baksteri – babai në zi që kërkon ngushëllim në Venecia, në qytetin e ujit dhe jehonave ku çdo rrugicë komploton për ta kthyer atë në ankthin dhe në pikëllimin të cilin vetëm vdekja mund ta shkarkojë.

Si detektiv Klyt që ia dha titullin filmit Klute, Sutherland ishte aq i matur dhe i kontrolluar sa që karakteri i tij bëhej po aq enigmë sa edhe çështja e personit të zhdukur për çfarë ai shkoi në Nju-Jork për ta zgjidhur si rast. Në një histori tronditëse, Sutherlandi e vë veten në pozicionin e vëzhguesit dhe pritësit të përkryer, duke mos i dhënë pothuajse asgjë qytetit që mund të marrë gjithçka që ti ke. Në atë hotel, në takimin e vitit 2015, mbaj mend që e pyeta për

efektin e mundshëm të topit të dëborës [proces që fillon me diçka që ka pak rëndësi, por që rritet, bëhet e madhe, serioze e ndoshta e dobishme apo shkatërrimtare] nga luajtja e kaq shumë roleve – le të themi nëse Presidenti Snou mund të shkëpuste fijen e lidhjes me Xhon Klytin, Xhon Bakesterin, Hokaj Pirsin [filmi M\*A\*S\*H], Methju Benelin [filmi Invasion of the Body Snatchers], Kalvin Xharetin [filmi Ordinary People]

... Në fakt, tha se nuk ishte aspak ashtu – dhe më pas biseda u zhvendos diku tjetër dhe mendimi mbeti i paplotë.

Në emailin e tij, atë e plotësoi. “Sa i përket përvojës së gjithë këtyre viteve”, shkroi ai, “është e ngjashme me punët e Kazanovës. Sa herë dashurohej, dhe ai dashurohej shumë herë, ishte hera e parë dhe e fundit. Kurrë më parë nuk ka qenë i dashuruar. Koha ndalonte. Dhe, fillonte sërish. Dhe, më pas, pas shumë lidhjeve u ndal”. /Telegrafi/



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## UEFA dënon Dakun me dy ndeshje moslojë

**NYON, 23 QERSHOR** - Nga 26 lojtarë në 25 të tillë. Shqipëria do të jetë me një lojtar më pak në takimin ndaj Spanjës, kjo pasi Mirlind Daku është dënuar me dy ndeshje moslojë. Dënimi për sulmuesin nga Gjilani erdhi, pasi pas

ndeshjes me Kroacinë më 19 qershor kishte ofenduar serbët dhe maqedonasit. Lajmin për dënimin e tij e ka konfirmuar edhe Federata Shqiptare e Futbollit. "Komisioni i Etikës dhe Disiplinës në UEFA ka dalë me një vendim në lidhje me

incidentin e ndodhur pas përfundimit të ndeshjes së "Euro 2024", Shqipëri-Kroaci, ku ishte i përfshirë sulmuesi kuqezi Mirlind Daku. Komisioni i UEFA-s ka vendosur të pezullojë për dy ndeshje futbollistin shqiptar, i cili nuk do të

mund të luajë kështu në ndeshjen e radhës ndaj Spanjës, në program për t'u luajtur të hënën e 24 qershorit në Dyseldorf", thuhet në njoftimin e FShF-së. Daku luajti vetëm 10 minuta në "Euro 2024", ato ndaj Kroacisë.



## Kuqezinjtë premtajnë maksimumin për kualifikimin historik

**EPOKA E RE** Veton ZYMBERI

**DUSSELDORF, 23 QERSHOR** - Kombëtarja e Shqipërisë sonte (e hënë) do të zhvillojë ndeshjen e tretë dhe të fundit në fazën e grupeve në Kampionatin Evropian "Euro 2024". Kuqezinjtë do të përballen me Kombëtaren e Spanjës me synim që të shkaktojnë befasi dhe të marrin fitore për të qenë në garë për kualifikim në fazën tjetër, që do të ishte historik kombëtar shqiptar. Në dy ndeshjet e para, Shqipëria luajti mirë, por regjistroi një humbje nga Italia dhe një barazim me Kroacinë. Në konferencë për medie një ditë para ndeshjes, trajneri i kuqezinjve, Sylvinho u shpreh se skuadra do japë maksimumin në fushë, në mënyrë që të kualifikohet. Sylvinho thotë se nuk firmos për barazim, pasi skuadra

që drejtohet prej tij do të synojë vetëm 3 pikët ndaj një rivali që është tejet i fortë. "Nëse kalojmë, do të jetë kënaqësi e madhe në 1/16 më të mira. Spanja është ekip i mirë, por ne do luajmë gjatë gjithë 90 minutave, nëse kalojmë tutje, do jetë diçka e mirë. Do të jetë mision i vështirë, por ne do të bëjmë performancën tonë më të mirë. Asnjëherë ndonjë trajner nuk dëshiron që skuadra të luajë për barazim. Edhe nëse nuk keni skuadër cilësore, gjithmonë do ketë tentativa për të fituar. Nëse duam të kalojmë, duhet të fitojmë. Ndoshta kalojmë edhe me 2 barazime, por ne shkojmë për të fituar", ka deklaruar trajneri brazilian i Shqipërisë. Në konferencë për medie krahas Sylvinho, prezent ishte edhe kapiteni Berat Gjimshiti, i cili po ashtu beson në kualifikim. "Është një sfidë ndaj një ekipi shumë të fortë, por besoj se të gjithë çunat



janë gati për sfidën. Gjëja më e rëndësishme është se jemi akoma në garë për të kaluar grupin dhe do të bëjmë maksimumin për të 'bezdisur' Spanjën. Asgjë nuk është e pamundur në jetë dhe këtë

e kam mësuar gjatë karrierës time, por patjetër do të jetë një ndeshje e vështirë, padyshim më e vështira në grup dhe siç thashë do të japim maksimumin për një kualifikim historik", ka thënë Gjimshiti.

Trajneri i Spanjës, Luis de la Fuente, para ndeshjes me Shqipërinë ka thënë se skuadra e tij ka prestigj ndaj do japë maksimumin në çdo ndeshje e më tej vlerësoi "kuqezinjtë", teksa i ka konsideruar si një ekip i madh, që meritoi të ishte pjesë e "Euro 2024". "Ne jemi të rrezikshëm dhe kemi prestigj, ndaj do t'i qasemi ndeshjes sikur të ishte e fundit e këtij kompeticioni. Ne duam të fitojmë çdo ndeshje. Nesër mendojmë për të fituar. Nuk na habit. Nëse ata janë këtu, kjo është për shkak se ata janë duke punuar mirë. Duhet të jemi të fokusuar dhe të punojmë mirë për të kërkuar fitoren", ka deklaruar ai. Në të njëjtën kohë zhvillohet edhe ndeshja tjetër e grupi B mes Kroacisë dhe Italisë.

**TË MËRKURËN TAKOHEN:**  
21:00 Shqipëri - Spanja  
21:00 Kroaci - Itali

## Gjermania barazon ndaj Zvicrës, Hungaria mund Skocinë



**FRANKFURT, 23 QERSHOR** - Grupi A mbyll zyrtarisht llogaritë për "Euro 2024". Gjermania arriti të merrte një barazim 1-1 ndaj Zvicrës, duke vendosur baraspeshën vetëm në minutat shtesë, në një duel që do të vuante shumë. "Helvetët" do të kalonin të parët në avantazh. Në minutën e 28-të, Freuler krosin në zonë, atje ku Ndoye e devijon mjaft mirë në rrjetën e portës së

mbrojtur nga Neueri. Gjermania vuajti shumë për t'u kundërpërgjigjur, ndërkohë që barazimi do të vinte vetëm në minutën e 92-të. Ky barazim mban skuadrën e Nagelsmann në krye të renditjes në Grupin A. Në ndeshjen tjetër, Hungaria mori një fitore 1-0 ndaj Skocisë në minutën e fundit shtesë. Barnabas Varga ra pa ndjenja në tokë pas një

përplasjeje në minutën e 69-të. Një situatë që solli ndërprerjen e menjëhershme të ndeshjes, ndërsa u desh ndërhyrja e shpejtë nga ana mjekësore për të shpëtuar lojtarin e Hungarisë, i cili u nxor me barelë nga fusha e lojës. Kevin Csoboth do të realizonte golin e vetëm për hungarezët në kohën shtesë, duke i dhënë 3 pikët e para ekipit të tij.

## Verstappeni triumfon edhe në Spanjë

Barcelonë, 23 qershor - Pas Çmimit të Madh të Kanadasë, Max Verstappen triumfon edhe në Spanjë në circuitin e Montmelo. Holandezi, u nis nga vendi i dytë pas Lando Norris, megjithatë në start ai që befasoi ishte George Russell që nga vendi i katërt ia doli të merrte kryesimin. Gjithsesi, pak metra mjaftuan dhe kampioni i trefishtë

i botës e parakaloi britanikun e Mercedes për të nisur më pas një shkëputje që i dhuroi qetësinë e duhur në garë. Situata për kreun u bë interesante në xhiron e 45 kur Verstappen pa t'i afrohej Norris dhe u fut në bokse për të vendosur gomat e buta. Piloti i McLaren mori kryesimin, por shpejt kuptoi se do t'i duhej edhe atij për të vendosur gomat e buta

për të qëndruar pranë Verstappen. Në fund, Norris provoi të shtynte në maksimum për t'i rrëmbyer fitoren Verstappen, por ishte holandezi që e kaloi i pari vijën e finishit. Norris i duhej të kënaqej me vendin e dytë ndërsa Hamilton fitoi duelin për vendin e tretë me shokun e skuadrës Russell ndërsa Leclerc e mbylli garën aty ku e

nisi, në vendin e pestë. Sa i takon Sainz, spanjoli u renditi gjashti ndërsa Sergio Perez u mjaftua me vendin e nëntë. Pas kësaj gare, Verstappen rrit edhe më shumë diferencat në krye të klasifikimit me pilotin e Redbull që është në kuotën e 194 pikëve, i ndjekur nga Leclerc me 138 pikë ndërsa në vend të tretë është Norris me 131 pikë.





ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS  
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

### THIRRJE PËR OFERTA KONKURS I PROJEKTIMIT ME VLERË TË VOGËL

**Kompani Huluntuose/Konsulent** për një analizë gjithëpërfshirëse të djegies profesionale (burnout) të mjekëve në Kosovë.

#### INFORMATA RRETH HULUMTIMIT

Hulumtimi ka për qëllim të realizojë një studim mbi shkallën e djegies profesionale (burnout) në mesin e mjekëve dhe të identifikojë faktorët kryesorë që nxisin migrimin e tyre.

Ky hulumtim është thelbësor për të kuptuar sfidat e përditshme me të cilat përballen mjekët në vendin tonë dhe për të nxjerr rekomandime praktike që synojnë përmirësimin e kushteve të punës dhe reduktimin e migrimit të profesionistëve shëndetësorë. Në këtë mënyrë, rezultatet e dala nga ky hulumtim synon të kontribuojë në ruajtjen dhe forcimin e kapaciteteve të sistemit shëndetësor në vend.

#### FUSHËVEPRIMI I DETYRËS

Konsulenti/Kompania huluntuose do të ketë përgjegjësi në realizimin e hulumtimit, të cilat përfshijnë:

- Realizimin e një hulumtimi të detajuar mbi djegien profesionale të mjekëve:**
  - Përgatitja e instrumenteve të hulumtimit, si anketat dhe intervistat, për të mbledhur të dhëna të sakta dhe të besueshme.
  - Analiza e faktorëve që kontribuojnë në djegien profesionale, duke përfshirë ngarkesën e punës, mungesën e përkrahjes dhe sfidat emocionale si dhe siguria ligjore.
- Identifikimin e arsyeve kryesore të migrimit të mjekëve:**
  - Intervistimi i mjekëve që kanë emigruar ose që janë në proces të migrimit për të kuptuar motivet e tyre.
  - Analiza e faktorëve socio-ekonomik, politik dhe institucional që ndikojnë në vendimin për të migruar.
- Vlerësimin e kushteve të punës:**
  - Zhvillimi i bisedave me stafin mjekësor dhe administrativ për të marrë një pasqyrë të plotë të sfidave dhe kushteve të punës.
- Hartimin e një raporti të detajuar me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse:**
  - Përgatitja e një raporti të strukturuar që përmbledh të gjitha gjetjet e hulumtimit.
  - Ofrimi i rekomandimeve të qarta dhe të zbatueshme për përmirësimin e kushteve të punës dhe mbajtjen e mjekëve në vend.
  - Prezantimi i raportit dhe rekomandimeve për palët e interesit përkatëse, duke përfshirë institucionet shëndetësore, politikëbërësit dhe organizatat e shoqërisë civile.

#### METODOLOGJIA

Elementet kyçe të metodologjisë janë:

- Hulumtim kuantitativ dhe kualitativ:**
  - Anketa:** Zhvillimi dhe shpërndarja e anketave të mjekëve për të mbledhur të dhëna statistikore mbi shkallën e djegies profesionale dhe identifikimi i faktorëve kryesorë që nxisin migrimin e tyre.
  - Intervista:** Kryerja e intervistave me mjekë për të marrë pasqyra të hollësishme mbi përvojat e tyre personale dhe profesionale.
  - Fokus grupe:** Organizimi i sesioneve të diskutimit me grupe mjekësh për të nxjerrë informacione kualitative dhe për të kuptuar perceptimet e tyre në lidhje me kushtet e punës dhe faktorët që ndikojnë në vendimin për të migruar.
- Analizë e literaturës ekzistuese mbi temën:**
  - Rishikimi i studimeve dhe raporteve të mëparshme për të identifikuar trendet dhe gjetjet e rëndësishme që lidhen me djegien profesionale dhe migrimin e mjekëve në vend.
  - Krahasimi i rezultateve të hulumtimit aktual me ato të literaturës ekzistuese për të siguruar kontekst dhe për të nxjerrë përfundime më të besueshme.
- Përpunimi i të dhënave dhe interpretimi i rezultateve:**
  - Analiza statistikore e të dhënave të mbledhura nga anketat për të identifikuar modelet dhe trendet kryesore të djegies profesionale.
  - Interpretimi kualitativ i të dhënave nga intervistat dhe fokus grupet për të kuptuar më mirë sfidat dhe përvojat personale të mjekëve.
  - Integrimi i gjetjeve kuantitative dhe kualitative për të krijuar një pasqyrë të plotë dhe holistike të situatës.
- Konsultimi me ekspertë të fushës dhe palët e interesit:**
  - Bashkëpunimi me ekspertë shëndetësor, akademik dhe profesionist të tjerë për të verifikuar dhe për të diskutuar gjetjet e hulumtimit.

- Angazhimi i palëve të interesit, përfshirë përfaqësues të institucioneve shëndetësore, politikëbërësve dhe organizatave të shoqërisë civile, për të marrë input dhe për të siguruar që rekomandimet janë të zbatueshme dhe të dobishme.

Kjo metodologji e kombinuar do të sigurojë një pasqyrë të qartë të problemeve të trajtuara, duke lejuar që rekomandimet të kenë një bazë të fortë të të dhënave dhe analizës.

#### MENAXHIMI I ANALIZËS SË SITUATËS

Konsulenti/Kompania huluntuose duhet të marrë një qasje të strukturuar dhe gjithëpërfshirëse për menaxhimin e analizës së situatës, duke siguruar që çdo aspekt i hulumtimit të trajtohet me kujdes dhe saktësi. Për të arritur këtë, duhet të ndiqen hapat e mëposhtëm:

- Planifikimi dhe Koordinimi:**
  - Zhvillimi i një plani të detajuar të hulumtimit që përfshin afatet kohore, burimet dhe përgjegjësitë.
  - Koordinimi i aktiviteteve të ekipit për të siguruar që çdo anëtar është i qartë për detyrat dhe afatet.
- Mbledhja e të Dhënave:**
  - Dizajnimi i instrumenteve të mbledhjes së të dhënave, si pyetësorët, udhëzuesit për intervista dhe strukturat për fokus grupet.
  - Kryerja e mbledhjes së të dhënave në terren, ku mostra e analizës është përfaqësues që mund të sigurojë njohuri domethënëse dhe përfundime të përgjithshme.
- Përpunimi dhe Analiza e të Dhënave:**
  - Përpunimi i të dhënave kuantitative duke përdorur metoda statistikore për të identifikuar modelet dhe korelacionet kryesore.
  - Analiza e të dhënave kualitative përmes teknikave si analiza tematike për të nxjerrë në pah tendencat dhe perceptimet kryesore.
  - Kombinimi i rezultateve nga të dy qasjet për të ofruar një pasqyrë të integruar dhe të hollësishme.
- Sigurimi i Cilësisë:**
  - Zbatimi i procedurave të kontrollit të cilësisë për të siguruar saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të mbledhura dhe analizës.
  - Rishikimi dhe validimi i të dhënave dhe rezultateve nëpërmjet konsultimeve me ekspertë dhe palët e tjera të interesit.
- Prezantimi i Rezultateve:**
  - Përgatitja e një raporti të detajuar dhe të strukturuar që prezanton gjetjet kryesore dhe rekomandimet.
  - Përdorimi i grafikëve, tabelave dhe ilustrimeve për të bërë rezultatet më të qarta dhe më të lehta për t'u kuptuar.
  - Organizimi i takimeve dhe prezantimeve për të komunikuar rezultatet dhe rekomandimet me palët e interesit përkatëse, duke siguruar një diskutim të hapur dhe konstruktiv mbi gjetjet.

Menaxhimi efektiv i analizës së situatës është thelbësor për suksesin e hulumtimit, duke garantuar që të dhënat e mbledhura dhe analizat e kryera janë të besueshme dhe të vlefshme për të informuar rekomandimet dhe vendimmarrjen.

#### AFATI KOHOR

Realizimi i këtij hulumtimi duhet të bëhet në afat kohor prej 1 muaj për përfundimin e plotë të të gjitha detyrave të përshkruara.

#### KUALIFIKIMET E APLIKANTIT

- Përvojë e dëshmuar në realizimin e hulumtimeve të ngjashme.
- Njohuri të thella mbi sistemin shëndetësor
- Aftësi të shkëlqyera analitike dhe raportimi.
- Aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe në ekip.

#### APLIKIMI

Aplikantët e interesuar duhet të dorëzojnë:

- Një letër motivimi.
- CV-në e detajuar të individëve kyç në hulumtim.
- Një propozim të detajuar metodologjik dhe financiar.
- Referenca nga hulumtimet e mëparshme të ngjashme.
- Certifikata e ARBK (e aplikueshme vetëm për kompanitë)

#### KRITERET E PËRZGJEDHJES

Përzgjedhja e aplikantit do të bazohet në:

- Cilësinë e propozimit metodologjik.
- Përvojën dhe kualifikimet e ekipit.
- Kostot financiare të propozuara.
- Referencat dhe reputacioni profesional.

#### DËRGIMI I OFERTAVE

Ofertat duhet të dërgohen në adresën [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org), deri më **01.07.2024, ora 16:00**. Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrat e telefonit: 049/872-300 apo 038/544-872.

Ne ju inkurajojmë të aplikoni dhe të bëheni pjesë e këtij hulumtimi të rëndësishëm për përmirësimin e kushteve të punës së mjekëve dhe për shëndetin e sistemit tonë shëndetësor.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejte](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156  +386 49 848 553

PRISHTINË

**Lumë's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 687 898

Sallon Depilimi Lumë's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Jehona (Salih) Latifi shpall të pavlefshme Diplomën e Kolegjit AAB Prishtinë, Baçelor me nr. 1204/17.
- Metihe Behluli shpall të pavlefshme Diplomën e shkollës së mesme "28 Nëntori" të SH.M.T. Prishtinë.
- Arfeta Alija shpall te pavlefshme dëftesën e kl I - VIII shfmu " Ekrem Rexha Drini " Prizren.
- Arta Elshani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Brigada 125 " Medvec.
- Fatima Aslanagic shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni" Prizren.
- Valdrim Osmanollaj shpall te pavlefshme dokumentet duplikat shme " Ymer Prizreni" Prizren.
- Rinor Bojaxhiu shpall te pavlefshme dëftesat e kl VI - IX shfmu " Nazmi Kokollari " Prizren.
- Gone Sinanaj shpall të pavlefshme dëftesën nga kl. I-V të sh.f. "Rexhep Kadrijaj" Rastavic KK Deçan.
- Naronë Shaqir Xhukolli shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme të mjekësisë "Dr. Ali Sokoli" Prishtinë.
- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)
- Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.
- Lëshoj banesën një dhomshe me qira , ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.
- Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales





**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA

# 1992

